

Departamenti i Kërcënimeve Transnacionale Njësia e Çështjeve Strategjike të Policisë

Policimi i Drejtuar nga Inteligjenca Nga reagimi tek parandalimi

OSBE-ja e promovon Policimin e drejtuar nga inteligjenca (DPI) si një qasje moderne dhe pro-aktive ndaj zbatimit të ligjit.



DPI adreson dy nga sfidat kryesore të zbatimit të ligjit në kohën e sotme: ndërlikueshmëritë gjithnjë e më të mëdha dhe natyrën transnacionale të krimit, dhe kërkesën më të madhe të

publikut për efikasitet financiar. Thelbësore për DPI-në është inteligjenca - të dhënat dhe informacioni i inteligjencës - i cili është faktor vendimtar në parandalimin dhe zvogëlimin e krimit.

DPI kërkon krijimin e strukturave dhe rrjedhave të punës për t'i menaxhuar dhe për t'i analizuar të dhënat dhe informacionin e inteligjencës, dhe për të siguruar përputhjen e këtyre praktikave me ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare, mbrojtjen e të dhënave dhe standardet e të drejtave të njeriut.

nga të gjitha nivelet.

DPI është e përqendruar në mbledhjen dhe analizën sistematike të të dhënave dhe informacioneve për:

- Përcaktimin e prioriteteve dhe qëllimeve strategjike dhe operacionale;
- Marrjen e vendimeve për politikën, strategjinë, operacionet dhe hetimet;
- Të siguruar alokimin racional të burimeve njerëzore, financiare dhe burimeve të tjera.

Tendencat e fundit në krimin e organizuar dhe terrorizmin kanë nxjerrë në pah nevojën për të shkëmbyer, lidhur dhe analizuar në mënyrë qendrore informacionin relevant të inteligjencës





Parakushtet kryesore për DPI të suksesshme:

- Një kornizë e qartë ligjore kombëtare në përputhje me standardet ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe parimet e mbrojtjes së të dhënave;
- Mbështetje politike dhe përkushtim i nivelit të lartë menaxherial;
- Staf i aftë për ta analizuar inteligjencën kriminale dhe udhëheqje që e di se si të përdorë produkte analitike në vendimmarrje dhe planifikim;
- Transformimi i kulturës dhe mentalitetit nga “duhet ta dini” në “duhet ta shpërndani” midis të gjithë punonjësve të zbatimit të ligjit;
- Bazat e të dhënave dhe

sistemi TI-së që e mbështesin DPI-në, që veprojnë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;

- Mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të monitorimit dhe të kontrollit;
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit të inteligjencës me komunitetin e zbatimit të ligjit në nivele rajonale dhe ndërkombëtare.

Manuali i OSBE-së për Policimin e Drejtuar nga Inteligjenca

Njësia e Çështjeve Strategjike të Policisë (NjÇSP) e Departamentit të Kërcënimeve Transnacionale të OSBE-së zhvilloi një Manual të OSBE-së për DPI. Manuali paraqet një qasje të përbashkët dhe

koherente për zbatimin e DPI-së në zonën e OSBE-së:


- Në të definohet DPI-ja dhe arsyetimin për promovimin e modelit DPI si një qasje bashkëkohore për zbatimin e ligjit;
- Në të mbulohen temat e rëndësishme të të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e të dhënave gjatë zbatimit të DPI-së;
- Në të është përshkruar si të analizohen të dhënat dhe informacionet që rezultojnë nga raportet strategjike dhe operacionale të përdorura për vendimmarrje të informuar dhe të bazuar në prova;
- Ai prezanton rekomandime praktike dhe standarde minimale të nevojshme për

departamentet e inteligjencës kriminale dhe mekanizmat e vendimmarrjes;

- Ai ofron mënyra me të cilat DPI-ja mund të mbështesë policimin në komunitet, si dhe masa efektive për ta adresuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që çojnë në terrorizëm.

Trajnimi

Duke u bazuar në këtë Manual, NjÇSP-ja ka dizajnuar seminare dhe punëtori rajonale dhe kombëtare të trajnimit, për ta prezantuar modelin e DPI-së të rekomanduar nga OSBE-ja dhe aplikimin e tij për forcimin dhe plotësimin e sistemeve ekzistuese të zbatimit të ligjit.



Për të mësuar më shumë Policimi i Drejtuar nga Inteligjenca

Manuali është në dispozicion në një numër gjuhësh në: www.osce.org/chairmanship/327476

Shikoni videon ku shpjegohen elementet kryesore të DPI-së në: www.osce.org/secretariat/403085

Ndiqui OSBE-në



□ Sekretariati i OSBE-së
Departamenti i Kërcënimeve Transnacionale
Njësia e Çështjeve Strategjike të Policisë
Wallnerstrasse 6
1010 Vjenë, Austri